



REPUBLIKAE KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

GJ.A.nr.194/2022

Datë: 22.02.2022

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykata (Ligji nr.06/L-054) dhe Rregullores Nr.02/2020 Për organizimin dhe veprimtarinë e brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, e bazuar në vendimin KGJK.nr.288/2021 të datës 18.10.2021, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i propozon Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, për miratim:

NDRYSHIMIN E PLANIT TË PUNËS SË GJYQTARËVE DHE ADMINISTRATES SË
GJYKATES THEMELORE NË PRISHTINË PËR VITIN 2022

PËR:

Transferimin e gjyqtarit Arton Fazliu nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, në Degën e Gjykatës në Podujevë – Departamenti i Përgjithshëm.

Transferimin e gjyqtarit Gazmend Bahtiri, nga Gjykata Degë në Podujevë – Departamenti i Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda.

A r s y e t i m

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka pranuar kërkesë nga gjyqtari Arton Fazliu për transferim nga Gjykata Themelore në Prishtinë në Gjykatën Degë në Podujevë, nën arsyetimin se i njëjti nga vendbanimi i tij në Komunën e Podujevës, udhëton çdo ditë mbi 100 km për në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe se bazuar në përgatitjen e tij dhe kualifikimin si gjyqtar i Departamentin të Përgjithshëm, kontributin e tij si gjyqtar do ta jep edhe në degë të gjykatës.

Kryetarja e gjykatës, pas diskutimit në kolegjum me gjyqtaret e GJTHP-së dhe me gjyqtaret e Degës në Podujevë, i propozon Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të miratoj transferimin e gjyqtarit Arton Fazliu për në Degë të Podujevës-Departamenti i Përgjithshëm dhe gjyqtarit Gazmend Bahtiri në GJTHP – Departamenti i Krimeve të Rënda, pasi që gjyqtari Bahtiri është gjyqtar me

përvojë të gjatë në lëmin penale dhe se kjo gjykatë ka nevojë për shtim të kapaciteteve në Departamentin e Krimeve të Renda.

Propozimi për ndryshim të planit të punës – transferimin e gjyqtarëve në fjalë, është i bazuar në kualifikimet e tyre si gjyqtar dhe se me këtë transferim do të sigurohet gjykim efikas i lëndëve.

Pjesa tjetër e planit të punës, mbetet e pandryshuar.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë

Albina Shabani – Rama

